



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	ARAL
Nr. i Faqeve Bc. Stranica No. Pages	- 04 -
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4684-2/22
Data Datum Date	19.05.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

DATË/A:	12.05.2023
REFERENC-Ë:	4684-2/22 - ZSP- 2023
PËR/ZA/TO:	„Gentipharm“ sh.p.k. , Rr. Mgj. Pri -Pejë , Park i Biznesit Korroticë e Epërme- k. Glllogoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Servet SPAHIU, Zëvendësues i Sekretarittë Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 4684-2/22 për shkarkim të ujërave të ndotura, parashtruar nga „Gentipharm“ sh.p.k. , Rr. Mgj. Pri -Pejë , Parku i Biznesit Korroticë e Epërme - K. Glllogoc dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Stalno Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë: 12.05.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjenive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e palës dhe dokumentacionit shtesë nga “**Gentipharm**” sh.p.k., Rr. Mgj. Pri –Pejë, Park i Biznesit Korroticë e Epërme - K. Gllogoc me Nr. prot. 4684-2/22, datë 20.04.2023 për **LEJE UJORE** për shkarkim ujërave nga K. Gllogoc, fabrikë e barnave, në koordinata: ( X = 7 496 843; Y = 4 718 147 ), në parcelen kadastrale nr. 00027/53 ne fl. Poseduese nr. 1049; sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, për fabrikën e barnave;
2. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
3. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues, kualitativ dhe kuantitativ (temperatura, pH, SHBO<sub>5</sub>, SHKO, sasia materieve te suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, paratrajtimi për specifikat e recipientit - kanalizimi publik ( ITUZ), duhet prezantuar në MMPHI, ;

Faqe 2 nga 4



4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe t'i kompensoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçant Rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjashtë muaj;
7. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. MMPH –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR”
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
10. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

#### ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: Certifikata e regjistrimit të biznesit të “Gentipharm” ( 810812124 ); Cetifikata e nr. Fiskal; Certifikata mbi te drejtën e pronës së paluajtshme nr 952/17288, K. Gillogoc; Akvendim mbi ndertimin e objektit, fabrikë për prodhimin e barnave, me Nr. 351-7102, dt 20.07.2011; Leje urbanistike nr. 353-6200, dt. 16.16.2011, vendim për pëlqim mjedisor Nr. 13/278/1-ZSP- 205/13, datë 25.09.2013; Vendim për Lejen Mjedisore të Integruar , me Nr. 18/5177/ZSP/ 21, datë 09.08.2021; Dokumentacionin tekniko investiv i shfrytëzimit të ujërave nga fabrika e barnave në korroticë të Epërme , K. Drenas; kontratat me hartuesin e projektit; Profili i Pusit; Llogaritja e parametrave hidrogjeologjik; Certifikata e biznesit të dëshmi për ixhinierin e diplomuar –Certifikata; Diplome Bach. e hidroinxinierit ; Plani i situacinit tematik, me perpjesë të lexueshme 1:1000, ashti qic kërkohet me U.A 03/2018 për procedurat per leje ujore, nënshkruar dhe vulosur nga person i licencuar me nr licence 228 – Agon ELSHANI; si dhe letërnjoftimi i tijë. CD-ja ;Pagesat për tarifat gjate aplikimit për K.U.; PU; L.U. Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, shikimit në vend , me 29.12.2022, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 4684-2/22 -ZSP- 2023, Datë: 12.05.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gllogoc;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Servet SPAHIU

